



Prishtinë, 5.10.2022

**Përgjigjet në komentet e pranuar gjatë procesit të konsultimit publik
për
Shqyrtimin e tarifave të energjisë termike – Raporti për të Hyrat e Lejuara për NQ
Termokos – sezoni 2022/2023**

1. Hyrje

Në përputhje me kërkesat ligjore, me datë 20 shtator 2022, ZRRE ka nxjerrë në konsultim publik Draft Raportin për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për NQ Termokos për sezonin 2022/2023. Me këtë rast të gjithë palët e involvuara dhe publiku i gjerë janë ftuar për të dhënë komentet e tyre në këtë Raport. Gjatë konsultimit publik ZRRE ka pranuar komentet me shkrim nga NQ Termokos dhe MFK ('Millennium Foundation Kosovo').

2. Përgjigjet në komentet e pranuar nga NQ Termokos

Koment 1: Kostoja e personelit

Sipas Skemës së re organizative të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, Departamenti për Investime Kapitale (Njësi për zhvillime kapitale ende nuk është plotësuar me stafin e paraparë. Lidhur me këtë, në marrëveshje me KfW dhe Termokosin, KfW me mjete të veta ka angazhuar një konsulentë ndërkombëtare për rekrutimin e stafit të këtij departamenti. Është planifikuar që ky staf të plotësohet gjatë vitit 2022, mirëpo për shkak të problemeve teknike në konkursin e shpallur nga konsulenca, nuk është rekrutuar stafi. Stafi i këtij departamenti sipas skemës organizative përbëhet nga drejtori dhe 11 punonjës. Buxheti për stafin e këtij departamenti është bërë, për shkak se në rast të mos buxhetimit rezulton në mos finalizim të skemës organizative.

Edhe në D. e Distribuimit dhe D. e Prodhimit, bazuar në skemën e re organizative dhe për shkak të zgjerimit të rrjetit në lagjen Kalabria dhe Mati 1, është i domosdoshëm plotësimi i vendeve të lira me kuadrot e nevojshëm, inxhinierë dhe punëtorë të kualifikuar, të cilët planifikohet të rekrutohen gjatë periudhës raportuese.

Shpenzimet për paga në periudhën gjashtëmujore (janar – qershor) TM2 të vitit 2022 është 1,330,000.00 euro, ndërsa planifikimi buxhetor për vitin 2022 është 2,683,000.00euro. Duke u bazuar në shpenzimin aktual për TM2, vërehet se deri në fund të vitit, dyfishi i kësaj shume korrespondon me planifikimin e buxhetit 2022.

Gjithashtu, duke pasur parasysh inflacionin në vend, Termokosi ka parapa edhe një përqindje të rritjes së pagave, pasi që në vitin aktual 2022, vërehet qartë se çmimet e produkteve bazë në një periudhë shumë të shkurtë kohore janë ngritur për 30%.



Përgjigje

Siç është theksuar edhe në Raportin e të Hyrave të lejuara, për koston e personelit NQ Termokos ka planifikuar një rritje mjaft të madhe – rreth 30% të koston së personelit krahasuar me realizimin e kësaj kostoje në periudhën e kaluar (tetor 2021 – tetor 2022), që nuk përkon me asnjë nga arsyetimet e përmendura më lartë. Lidhur me këtë fillimisht duhet theksuar se gjatë monitorimit të realizimeve në periudhat e kaluara, në vazhdimësi është konstatuar tejkalim i kësaj kostoje nga lejimet përkatëse në shqyrtimet tarifore.

Në propozimin e kësaj kostoje NQ Termokos kryesisht ka dhënë arsyetimet e njëjta për rekrutim të stafit shtesë ashtu siç parashihet me Rregulloren për organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës nxjerrur nga Bordi i NP Termokos në fund të vitit 2019, si dhe për një rritje të pagave për të reflektuar inflacionin. Sa i përket rekrutimit të stafit shtesë duhet theksuar se sipas informatave nga NQ Termokos ende deri më tani nuk ka pasur ndonjë plotësim të pozitave të reja me staf të rekrutuar, e gjithashtu nuk është hartuar dhe dorëzuar ndonjë plan i rekrutimit i cili do të paraqiste prioritetet në rekrutimin e stafit të ri për pozitat vakante, afatet kohore dhe arsyetimet përkatëse të rekrutimeve në përputhje me shtimin e operimeve të ndërmarrjes.

Për sa i përket rritjes së pagave për të reflektuar inflacionin që sipas vlerësimit të ndërmarrjes është rreth 30% (edhe pse jo i bazuar në të dhënat zyrtare të agjencisë të statistikave), fillimisht duhet theksuar, se përkundër faktit të një inflacioni evident në vend që vjen për arsye të rrethanave objektive ndërkombëtare, në sektorin publik nuk ka pasur rritje të pagave. Duhet po ashtu të theksohet fakti i cili vlen në përgjithësi lidhur me kompetencat menaxheriale të ndërmarrjes në raport me rregullimin: Gjatë menaxhimit të afarizmit të ndërmarrjes menaxhmenti ka kompetenca ligjore të merr vendime që i vlerëson të nevojshme por të cilat jo-domosdoshmërisht mund të jenë të arsyeshme nga aspekti i rregullimit; në këtë kontekst Rregullatori gjithnjë kujdeset që vendimet e ndërmarrjes të mos ndikojnë në një ngarkesë shtesë për konsumatorët, siç paraqet në rastin konkret vendimi për rritjen koston së personelit gjegjësisht të pagave. Rregullatori gjithnjë kujdeset që për çfarëdo ngarkese shtesë konsumatorët të marrin si kundërvlerë një furnizim të mjaftueshëm dhe shërbim cilësorë.

Nga sa u tha më lartë ZRRE mendon se rritja e propozuar e koston së personelit nuk është e arsyetuar dhe e justifikuar sa duhet. Konkretisht ZRRE vlerëson se shtimi i vendeve të punës duhet të jetë në përputhje të plotë me shtimin e operimeve të ndërmarrjes duke përmirësuar shërbimin publik dhe sjellë përfitime për konsumatorët. Për këtë ZRRE mbetet pranë qëndrimit të vet për shumën e lejuar të koston së personelit.

Koment 2: Investimet nga donacionet – Projekti i MCC: Instalimi i matësve të energjisë termike

Sipas marrëveshjes në mes Termokos dhe MFK, punimet për instalimin e pajisjeve matëse, do të vazhdojnë edhe gjatë sezonës ngrohëse 2022/2023.

Bazuar në komentet – sqarimet e MFK, vlera e këtij projekti është amandamentuar në gusht të këtij viti në vlerën prej 8,209,789.12 eurosh . Gjithashtu nga MFK sqarohet se vlera e përafërt e planifikuar për investime duke marrë parasysh vetëm pajisjet matëse dhe softueri, arrin deri 4,286,579.41 euro. Prandaj kërkohet që të rishqyrtohet vlera e pranuar nga ZRRE dhe lejohet vlera e amandamentuar e projektit 8,209,789.12 euro .

Përgjigje:



Për këtë projekt fillimisht duhet theksuar se, për shkaqe objektive, ka pasur vonesa të shumta në drejtim të fillimit të implementimit të projektit, të cilat janë përcjell vit pas vitit. Në këtë kontekst duhet përmendur se, në shqyrtimin e kaluar tarifor ky investim është lejuar në vlerë 1.5 mil €, përderisa realizimi i këtij projekti investiv ka qenë 0. Me gjithë pohimin e juaj se punimet do të vazhdojnë edhe gjatë sezonës ngrohëse, ZRRE vlerëson se kryerja e punimeve gjatë sezonit të ngrohjes do të këtë pengesa e rrjedhimisht edhe vonesa; sidomos kjo vlen kur është fjala tek instalimi i valvulave termostatike në radiatorë dhe pompave qarkulluese në nënstacione, e po ashtu edhe matësve individual të apartamenteve.

Sa i përket rritjes së vlerës së investimeve në gusht të këtij viti nga vlera fillestare e kontraktuar 6,905,850 € në 8,209,789 €, duhet thënë se vlera fillestare është paraqitur nga ju në aplikacion dorëzuar me 27 korrik 2022. Gjithashtu e njëjta vlerë është paraqitur edhe aplikacionin tuaj të përmirësuar dhe plotësuar pas komenteve të ZRRE-së, që është ri-dorëzuar me 19 gusht 2022. Në ndërkohe ne nuk jemi informuar as nga NQ Termokos as nga MFK për rritjen e vlerës së projektit, deri me tani, kur procesi i shqyrtimit tarifor është në fazën e fundit.

Për sa i përket çështjes së pronësisë së këtyre aseteve duhet theksuar se, për pajisjet matëse ekziston përcaktimi ligjor i obligimit për instalim dhe të drejtës së pronësisë së ndërmarrjes në këto pajisje. Ndërsa valvolat termostatike konsiderohen si asete të konsumatorëve, e që paraqesin një pjesë të konsiderueshme të aseteve të planifikuara për investim. Kështu që duhet një përcaktim i qartë për pronësinë e aseteve në mënyrë që të saktësohet vlera e aseteve të investuar që do të regjistrohet në pronësi të NQ Termokos, e rrjedhimisht do të përfshihet në Bazën e rregulluar të aseteve (RAB) për llogaritjet e mëtejme të kostos së kapitalit dhe përgjithësisht të hyrave të lejuara.

Bazuar në konstatimet e lartë-përshkruara ZRRE mbetet pranë vlerësimeve të paraqitura në Raportin Rregullativ për konsultim publik për vlerën e pritshme / parashikuar të realizimit të këtij projekti investiv. Gjithsesi pas realizimit të projektit dhe vlerave të sakta të aseteve të instaluar dhe të regjistruara në pronësi të ndërmarrjes, do të bëjë korrigjimet dhe axhustimet përkatëse në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

Koment 3: Investimet nga donacionet – Projekti i KfW: ‘Solar4Kosova’

Për këtë projekt , tenderi për konsulencë është në procedurë e sipër dhe mbyllet me 18 tetor 2022. Prandaj sipas të gjitha gjasave , do të fillojë të realizohet faza e projektimit dhe zgjedhja e kontraktorit.

Përgjigje:

Siç është theksuar në Raportin e të Hyrave të lejuara, ky projekt është në fazën e studimit të fizibilitetit, përderisa NQ Termokos, për periudhën e shqyrtimit tarifor 2022/’23, ka paraqitur vlerën e planifikuar të realizimit në vlerë prej 5 mil.€, vlerë kjo që i dedikohet për punët përgatitore dhe projektuese.

Pra, dedikimi i mjeteve për investim i përket punëve përgatitore dhe projektuese, që nuk konsiderohen detyrimisht investim specifik në asete. Po ashtu ky projekt është në fazën fillestare studimore dhe për këtë vlerësohet se planifikimi i realizimit të investimit për këtë projekt në periudhën e shqyrtimit tarifor nuk pasqyron kohëzgjatjen e zakonshme që nevojitet për përfundimin e fazës studimore dhe të zhvillimit të projektit. Prandaj ZRRE qëndron pas vlerësimeve të veta, dhe për periudhën e këtij



shqyrtimi tarifor nuk e pranon këtë investim. Gjithsesi ZRRE do të përcjellë progresin e zhvillimit të këtij projekti dhe do të bëjë vlerësimet dhe përshtatjet e duhura në shqyrtimet e ardhshme tarifore.

Koment 4: Investimet nga donacionet – Projekti i EU-EIB për dyfishimin e kapaciteteve të ekstraktimit të energjisë termike nga sistemi i ko-gjenerimit

‘Ky projekt është në fazën përgaditore’

Përgjigje:

Ky projekt është në fazën fillestare studimore në kuadër të IPA-s mbështetur nga EU dhe EIB në vlerë të parashikuar prej 25 mil€, ndërsa për periudhën e shqyrtimit tarifor 2022/’23, NQ Termokos ka paraqitur vlerën prej **1.5 mil. €** që planifikohet të realizohet kryesisht për hartimin e studimeve preliminare.

Për shkak se ky projekt është në fazën fillestare studimore, planifikimi i ndërmarrjes vlerësohet si jorealit duke marrë parasysh kohëzgjatjen e zakonshme për përgatitjen e studimit. Po ashtu vlera e paraqitur dedikohet ekskluzivisht për hartimin e studimit preliminar. Prandaj ZRRE mbetet pranë vlerësimeve fillestare dhe për këtë periudhë të shqyrtimit tarifor nuk e pranon vlerën e paraqitur për këtë projekt investiv.

ZRRE do të përcjellë në vazhdimësi ecurinë e kësaj faze studimore të projektit dhe do të bëjë vlerësimet dhe përshtatjet e duhura në shqyrtimet e ardhshme tarifore.

Koment 5: Investimet e reja me vetë-financim – Investimet në kaldajat me mazut në ngrohtoren e NQ Termokos

“Është fakt që rehabilitimi i pjesshëm i kaldajës K-2 në NQ në planin zhvillimor është planifikuar për periudhën (2023-2024), mirëpo duke parë gjendjen faktike të kaldajave pas funksionalizimit të tyre në sezonin e kaluar, është parë e nevojshme dhe e domosdoshme që të investohet në rehabilitimin e tyre në periudhën 2022-2023.”

“Kaldajat janë të trashëguara që nga paraluftra deri më sot. Prej vitit 2014, në bazë të raportit që ne u kemi dërguar kaldajat nuk kanë funksionuar deri në vitin e kaluar për 7 orë për prodhim të energjisë termike në mungesë të furnizimit me avull nga KEK. Gjatë funksionimit të kaldajave me këtë rast, kemi detektuar nevojën urgjente për investim në rehabilitimin e tyre. Prandaj, jo vetëm për vitin 2022, që planifikohet të investohet shuma e ndarë prej 500,000euro, por e kemi pa të nevojshme që edhe vitin që vjen 2023 të planifikojmë shumën prej 250,000euro. Të gjitha këto investime kapitale janë bërë që kaldajat në fjalë të jenë sa më funksionale, në mënyrë që kur të jetë nevoja t’i vëmë në funksion, të furnizohemi prej tyre me kapacitet të plotë.”

“Sa i përket ndikimit në mjedis nga ndotjet prej kaldajave, aktualisht Termokosi është në proces të kompletimit të dokumentacionit për plotësimin e kriterëve që janë paraparë për marrjen e Lejes Mjedisore të Integruar.”



Përgjigje:

Fillimisht duhet theksuar se komentet e lartë-përshkruara nuk përkojnë me një qasje të planifikimit real dhe të bazuar në gjendje faktike. Në këtë kontekst duhet të ritheksohet fakti se ka shmangie nga planifikimet në Planin Zhvillimor që është aprovuar këtë vit – ka tejkalim të vlerave të investimit dhe gjithashtu afatet kohore nuk përputhen. Kjo sidomos vlen rehabilitimin e kaldajës K2 për të cilën është ndryshuar afati i planifikuar i realizimit.

Po ashtu duhet përmendur se këto stabilimente janë në proces të marrjes së lejes mjedisore dhe për këtë arsye ZRRE ende nuk ka mundur të pajis ndërmarrjen me licencë për aktivitetin e prodhimit të energjisë termike nga këto impiante. Prandaj është e këshillueshme që në këtë fazë të ndërmerren me prioritet vetëm investimet të ndërlidhura me plotësimin e kushteve mjedisore.

Nga sa u tha më lartë ZRRE vlerëson se shuma e lejuar për këtë periudhë është e mjaftueshme për ndërmarrjen e investimeve të nevojshme në impiantet e prodhimit të energjisë termike në ngrohtore për të përmirësuar sigurinë e furnizimit me energji termike dhe plotësuar kërkesat mjedisore.

Koment 6: Investimet e reja me vetë-financim – Ndërtimi i objektit të NQ Termokos

Lidhur me investimet e reja me vet-financim, konkretisht për ndërtimin e objektit të zyrës qendrore dhe administrative të NQ Termokos ka dërguar disa komente si në vijim:

Lidhur me mos realizimin të projektit gjatë vitit të kalur, siç ju kemi informuar problemi ka qëndruar tek zgjatja në vazhdimësi e procedurave të prokurimit për shkak të ankesave të operatorëve ekonomik në OSHP dhe nga mungesa e Bordit të OSHP. Meqenëse Bordi i OSHP është zgjidhur, planifikojmë që në periudhën raportuese të zgjidhet operatori dhe të fillojë ndërtimi i objektit. Aktualisht lënda është duke u trajtuar në OSHP, dhe së shpejti presim vendimin nga ky organ.

Sa i përket rritjes së vlerës së investimit, siç ju kemi informuar në raportimet e kaluara, arsyeja qëndron se, me hartimin e projektit detal ka ndërruar koncepti i ndërtimit të objektit duke rritur dukshëm përmasat e objektit dhe etazhitetin (specifikat e projektit ua kemi dërguar në raportimet e mëparshme), që natyrisht ka rezultuar me një vlerë dukshëm më të madhe se vlera fillestare e paraparë, si për koston e ndërtimit të objektit, poashtu edhe në rritjen e kostos për mbikqyrje të punimeve.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të trendit të rritjes së çmimeve në vend dhe shkallën e lartë të inflacionit, nuk jemi të sigurtë nëse vlera e ndarë prej 2.2 milion euro për ndërtimin e objektit, do ta mbulojë koston e këtij projekti.

Prandaj kërkojmë që të rishqyrtoni vlerën e lejuar në këtë shqyrtim tarifar dhe të apromoni vlerën e planifikuar nga Termokosi prej 1,000,000.00 euro për ndërtim të objektit dhe 60,000.00 euro për mbikqyrje të punimeve.

Përgjigje:

Ashtu siç është përshkruar edhe në Raportin për konsultim publik, ZRRE ka dhënë vlerësimet përkatëse të cilat, ndërlidhur me komentet e lartë-përshkruara, përmbledhen si në vijim:



- Me hartimin e projektit detal ka ndërruar koncepti i ndërtimit të objektit duke rritur dukshëm përmasat e objektit dhe etazhitetin, që ka përfshirë edhe punime shtesë dhe kjo natyrisht ka rezultuar me një vlerë dukshëm më të madhe se vlera fillestare e paraparë e investimit për këtë projekt. Gjithashtu duhet përmendur se projekti i ndërtimit të objektit administrativ është përfshirë në Planin zhvillimorë afatgjatë në vlerë prej 530,000 €. Po ashtu duhet theksuar një dukuri, që në vazhdimësi nga sezoni në sezonë vërehet rritja e vlerës së parashikuar për ndërtim të objektit – nga vlera fillestare prej 550,000 €, në sezonin e kaluar është parashikuar vlera prej 1,350,000€, ndërsa në këtë sezon vlera e parashikuar ka arritur në 2,320,000€. Lidhur me këtë, ZRRE dëshiron të theksoj se ndryshimet përkatëse të investimeve paraprakisht të aprovuara duhet të jenë mirë të arsyetuara dhe të argumentuara.
- Sa i përket realizimit të këtij investimi duhet thënë se, në shqyrtimin tarifor për sezonin 2019/2020, ZRRE ka pranuar investimin për ndërtimin e objektit në shumën 530,000, prej së cilës shumë janë realizuar vetëm 67,980 € (12.83%) për hartimin e Studimit të Fizibilitetit: Vlerësim i situacionit dhe objekteve të NP"Termokos"sh.a. dhe hartimin e projektit detal ndërtimor. Ndërsa në shqyrtimin për sezonet e kaluara 2020/'21 dhe 2021/22 është lejuar vlera prej 482,000 €, e cila vlerë gjatë këtyre periudhave nuk është realizuar fare për shkak të vonesave në procesin e tenderimit.

Duke ju referuar përgjigjeve më lartë dhe sidomos ecurinë e deritanishme të këtij projekti gjegjësisht ngecjen e deritanishme në realizim, ZRRE qëndron pranë vlerësimeve të veta për vlerën e lejuar të investimit për ndërtimin e objektit të ri administrativ. Konkretisht shumën e lejuar në shqyrtimin e kaluar prej 482,000 € e bartë në shqyrtimin aktual tarifor për sezonin 2022/2023.

Koment 7: Bashkëfinancimi në projektet e donatorëve

"Për projektin e KW për zgjerim dhe rehabilitim të rrjetit , kërkojmë që të pranohet vlera e bashkëfinancimit prej 2.5 milion euro, sepse është vlera minimale që do të paguhet nga termokosi për periudhën raportuese. Kjo për shkak se kemi obligim sipas marrëveshje në mes Termokos- KfW dhe Komunën e Prishtinës, që vlera e projektit që kalon mbi 10 milion euro duhet të mbulohet nga Termokosi me mjete vetanake. andaj kërkojmë që kjo vlerë të pranohet e plotë 2.5milion euro."

"Ndërsa për Projektin EU-EIB për dyfishimin e kapaciteteve të ekstraktimit të energjisë termike nga sistemi i kogjenerimit, edhe për këtë projekt Termokosi është zotuar se do t'i paguaj 2.5milion euro për 5 vite nga 0.5milion euro në vit.

*Prandaj, bazuar në sa u tha më lartë, kërkojmë që të pranohet vlera e bashkëfinancimit prej **3 milion euro** për të dy projektet e cekura."*

Përgjigje:

Duke ju referuar përgjigjeve në komentet '3' dhe '4', si dhe faktit se shumat e paraqitura duhet të pasqyrojnë statusin aktual të projekteve, progresin e projekteve dhe planifikimeve përkatëse të implementimit të tyre, atëherë vlerësohet se vlera e lejuar nga ZRRE është në përputhje me argumentet e përshkruara – statusin aktual të projekteve dhe pritjet realiste ndërlidhura me implementimin.



3. Përgjigjet në komentet e MCC-MFK

Komentet e MCC-MFK kanë të bëjnë me projektin e **Instalimit të matësve të energjisë termike, dhe** janë të ngjashme me komentin '2' – konkretisht rritja e vlerës së investimit nga vlera fillestare e kontraktuar 6,905,850 € në 8,209,789 € për shkak të shtimit të sasisë së dhe vëllimit të punëve instaluese; ky amendim i kontratës fillestare është bërë në gusht të këtij viti. Pra komentet e MFK janë përqendruar kryesisht në korrigjimin e vlerës së investimit dhe sasive të pajisjeve pas amendimit të kontratës.

Përgjigje:

Sa i përket rritjes së vlerës së investimeve në gusht të këtij viti nga vlera fillestare e kontraktuar 6,905,850 € në 8,209,789 €, duhet thënë se vlera fillestare është paraqitur nga NQ Termokos në aplikacion dorëzuar me 27 korrik 2022. Gjithashtu e njëjta vlerë është paraqitur edhe aplikacionin tarifor të përmirësuar dhe plotësuar pas komenteve të ZRRE-së, që është ri-dorëzuar me 19 gusht 2022. Në ndërkohe ne nuk jemi informuar as nga NQ Termokos as nga MFK për rritjen e vlerës së projektit, deri me tani, kur procesi i shqyrtimit tarifor është në fazën e fundit.

Për sa i përket çështjes së pronësisë së këtyre aseteve duhet theksuar se, për pajisjet matëse ekziston përcaktimi ligjor i obligimit për instalim dhe të drejtës së pronësisë së ndërmarrjes në këto pajisje. Ndërsa valvolat termostatike konsiderohen si asete të konsumatorëve, e që paraqesin një pjesë të konsiderueshme të aseteve të planifikuara për investim. Kështu që duhet një përcaktim i qartë për pronësinë e aseteve në mënyrë që të saktësohet vlera e aseteve të investuar që do të regjistrohet në pronësi të NQ Termokos, e rrjedhimisht do të përfshihet në Bazën e rregulluar të aseteve (RAB) për llogaritjet e mëtejme të kostos së kapitalit dhe përgjithësisht të hyrave të lejuara.

Bazuar në konstatimet e lartë-përshkruara ZRRE mbetet pranë vlerësimeve të paraqitura në Raportin Rregullativ për konsultim publik për vlerën e pritshme / parashikuar të realizimit të këtij projekti investiv. Gjithsesi pas realizimit të projektit dhe vlerave të sakta të aseteve të instaluar dhe të regjistruara në pronësi të ndërmarrjes, do të bëjë korrigjimet dhe axhustimet përkatëse në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

Përgatitur nga DETG, ZRRE